

## AKT-THEMELIMI

Per themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "A&M TEKSTIL" sh.p.k.

Shpallur sot me date 6.07.2004, nga ortaku i vetem  
- Ardjan Meshja, i biri i Kasemit, dtl 25.07.1965, banues ne lagjen nr 3 Cerrik,  
Elbasan.



### Neni 1

#### Objekti I aktit te themelimit

Themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar per te zhvilluar veprimtari ekonomike ne fushen e prodhimit dhe tregimit te konfeksioneve, stofrave e perhurave etj, tregeti te artikujve te ndryshem, import-eksport etj.

### Neni 2

#### Emertimi dhe selia

Shoqeria emertohet "A&M TEKSTIL" sh.p.k.  
Selia e shoqerise eshte ne qytetin Cerrik, lagja NR 3.

### Neni 3

#### E drejta

Shoqeria "A&M TEKSTIL" sh.p.k. eshte person juridik I se drejtes shqiptare qe ushtron veprimtari ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktin e themelimit dhe statutin.

### Neni 4

#### Pergjegjësia

Shoqeria pergjigjet me pasurine e saj per detyrimet e saj. Ajo nuk pergjigjet per detyrimet e ortakut te vetem dhe ky i fundit perballon humbjet e shoqerise deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar.

### Neni 5

#### Objekti I shoqerise

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

1-Prodhome te tekstileve, pelhurave dhe metrazheve te ndryshme grexo, dhe tregitimine tyre me shumice dhe pakice.

2-tregetim te paisjeve hidrosanitare dhe makineri e paisje te ndryshme.

3-Tregitim in me shumice e pakice te artikujve te ndryshem ushqimore e industriale.

-Eksport-import

Neni 6  
Kohezgjatja e shoqerise

Shoqeria formohet per nje afat te pacaktuar. Afate te caktuara mund te vendosen me vendim te ortakut te vetem.

Neni 7  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100.000 leke, dhe perfaqesohet nga kontribute ne para. Ky kapital ndahet ne 100 pjese me nje vlere 1000 leke secila. Te gjithë pjeset e kapitalit themeltar si me sipër janë, nënshkruar dhe shlyer nga ortakut i vetem.

Neni 8  
Organet

Organe drejtues te shoqerise jane ortakut i vetem dhe administratori.

Neni 9  
Administrimi

Administrator i vetem i shoqerise eshte, z. Ardjan Mesha.  
Kompetencat e administratorit caktohen ne statutin e shoqerise.

Neni 10  
Llogarite

Shoqeria do t'i realizoje transaksionet e saj financiare nepermjet llogarive rrjedhese qe do te hape ne bankat shqiptare dhe te huaja. Per kapitalin themeltar te shoqerise eshte hapur libri i llogarive dhe shoqeria ka dhe perdor dokumentacionin financiar ne perputhje me dispozitat ne fuqi per kontabilitetin.

Neni 11  
Fitimi

Nga fitimi I realizuar, shoqeria do te leje menjane si rezerve e domosdoshme 1/20 e tij, derisa kjo rezerve te arrije 1/10 e kapitalit themeltar.  
Fitimi e realizuar, pasi te jete hequr shuma e nevojshme per rezerven e domosdoshme dhe pasi te jene zbritur apo shtuar respektivisht humbjet ose fitimet e bartura te shoqerise, kalon per llogari te ortakut te vetem.

Neni 12



## Zbatimi I ligjit

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete akt dhe ne statut, vlejne dispozitat e ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjeve e akteve te tjera nenligjore.

### Neni 13

#### Themelimi I shoqerise

Shoqeria konsiderohet e themeluar ne perputhje me aktin e themelimit dhe statutin e saj, bashkangjitur ketij akti.

### Neni 14

Ky akt hartohet ne kater kopje origjinale, dhe pasi u lexua dhe u gjend konform vullnetit te lire te ortakut te vetem, firmoset rregullisht prej tij.

ORTAKU I VETEM

ARDJAN MESHA  
ARDJAN MESHA

